

Fjala e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.
Raporti i Performancës së institucionit për vitin 2017

Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit funksionon bazuar në Kushtetutën e vendit, në ligjin organik të institucionit, në standardet ndërkombëtare të auditimit, në Rezolutat e OKB-së për SAI-t dhe në Rezolutat e Kuvendit për KLSH-në.

Filozofia e punës sonë në këto vite ka qenë modernizimi i institucionit dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit, për përmirësimin e qeverisjes, duke vepruar me moton “KLSH-shërbëstar i qytetarit dhe agjent i Kuvendit”.

Në këtë vit të fundit të mandatit 2012-2018, paraqesim raportin përpara Kuvendit në lidhje me aktivitetin auditues dhe performancën institucionale të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017, bazuar në Kornizën e Matjes së Performancës së institucioneve supreme të auditimit(SAI-ve)¹, një dokument i miratuar si standard për t’u përdorur nga të gjitha SAI-t në Kongresin e INTOSAI-t, INCOSAI i XXII-të në dhjetor 2016 në Abu D’habi të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Në mënyrë skematike, kjo kornizë paraqitet nëpërmjet diagramës së mëposhtme:

¹ “Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve”, Seria: Botime KLSH – 07/2017/74, Tiranë 2017

KUADRI I MATJES SË PERFORMANCËS SË SAI-t

Kapaciteti institucional i SAI-t

Sistemet organizative të SAI-t dhe Kapaciteti profesional i stafit

Produktet e SAI-t

Vlerat dhe përfitimet e SAI-t

A

Pavarësia dhe kuadri ligjor

B Etika dhe Qeverisja e Brendshme

C Cilësia e auditimit dhe raportimi

Standardet e auditimit financiar. Procesi dhe Menaxhimi i Cilësisë

Standardet e auditimit të performancës. Procesi dhe Menaxhimi i Cilësisë

Standardet e auditimit të përputhshmëri Procesi dhe Menaxhimi i Cilësisë

Standardet e kontrollit gjyqësor. Procesi dhe Menaxhimi i Cilësisë financiar

Mbulimi me auditim financiar, përputhshmërie dhe performance, Mbulimi me kontroll gjyqësor

Rezultati i auditimit financiar

Rezultatet e auditimit të performancës

Rezultatet e auditimit të përputhshmërisë

Rezultatet e kontrollit

Kontributi i SAI-t në:

Fuqizimin e përgjegjsh mërisë,

Transparen cën dhe Integritetin

Të qenurit të përshtatshëm në vijmësi

D Menaxhimi Financiar, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse

E Burimet njerëzore dhe Trajnimet

F Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të interesit

Udhëheqja e SAI-t dhe Kultura


Konteksti i Vëndit, Qeverisja dhe Ambjenti i Menaxhimit të Financave Publike

Vlerësimi dhe zbatimi i Kornizës së Matjes së Performancës konsiderohet jetik dhe një instrument për të realizuar analizën në rrënjë, të shkaqeve dhe pasojave të çdo elementi të aktivitetit auditues, që duhet të përmirësohen dhe zhvillohen në përputhje me standardet e INTOSAI-t, ISSAI. Kjo qasje metodologjike nuk përbën qëllim në vetvete, por synon përmbushjen e misionit kushtetues të institucionit dhe vlerën e shtuar në shërbimin ndaj qytetarit.

Metodologjia mbështetet në sistemin e vetëvlerësimit dhe në procesin e vlerësimit nga institucionet e tjera supreme të auditimit “Peer Review (Rishikim mes Kolegëve)”, qasje e zgjedhur në kushtet e burimeve të kufizuara.

Secila prej fushave përmban tregues specifikë, duke formuar një matricë të përbërë prej 25 treguesish, me pikëzime(vlerësime) për çdo dimension që ka treguesi. Çdo tregues përmban 2-4 dimensione, të cilat formësohen nga një listë e detajuar kriteresh, të specifikuara me referencat përkatëse sipas ISSAI-ve, apo dokumenteve bazë të INTOSAI-t, EUROSAT-t dhe organizatave të tjera rajonale të auditimit suprem publik. Kjo matricë treguesish shpreh faktin që institucionet supreme të auditimit janë institucione komplekse, si dhe që treguesit e performancës të aspekteve të ndryshme të tyre, janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin.


Ndërlidhja midis fushës, treguesit, dimensionit dhe kriterëve paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Raporti i vlerësimit të performancës së institucionit pasqyron rezultatet e matura mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga standardet e INTOSAI-t dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, të cilat janë grupuar sipas gjashtë fushave të mëposhtme:

- A. “Pavarësia dhe korniza ligjore”
- B. “Qeverisja e brendshme dhe etika”
- B. “Cilësia e auditimit dhe raportimi”
- C. “Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse”
- D. “Burimet Njerëzore dhe Trajnimi”.
- E. “Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit”.

Treguesit e agreguar dëshmojnë se KLSH ka një performancë mbi nivelin mesatar. Konkretisht për tre nga 6 fusha e vlerësimit, përkatësisht fushat 3,4 dhe 5 merr vlerësimin 4(nga) dhe për 3 fushat e tjera vlerësimin 3 (nga 5)².



A. Fusha “Pavarësia dhe korniza ligjore”

Vlerësimi i kësaj fushe të performancës së KLSH është bazuar kryesisht në vlerësimin e realizuar nga Gjykata Austriake e Auditimit, përmes procesit “Peer Review(Rishikim mes kolegëve)”. Me ndryshimet e realizuara në Ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH ka një kornizë rregullatore që i siguron një pavarësi të përshtatshme për të realizuar plotësisht misionin dhe detyrimet e tij kushtetuese.

Kjo kornizë sanksionon pavarësinë organizative në planin e auditimeve, në strukturën dhe stafet e nevojshme për t’iu përgjigjur detyrimeve kushtetuese dhe aktivitetit të përditshëm auditues. Pavarësia e Kryetarit është një element që sanksionohet në mënyrë të kujdesshme në ligjin e ri, fakt që bën që dimensionet e lidhura me pavarësinë të kenë një vlerësim maksimal. Ndërkohë që dimensionin e lidhur me pavarësinë financiare, nisur nga kufizimet buxhetore për shkak të ligjeve të tjera organike, nuk plotëson kushtet për një vlerësim maksimal, duke u vlerësuar vetëm me 3 nga 4 pikë të mundshme.

Mandati i KLSH-së është vlerësuar duke analizuar dimensionin e mjaftueshmërisë së mandatit, lidhur me të drejtën për të audituar dhe kufizimet lidhur me këtë të drejtë. Vlerësimi tregoi se KLSH ka një mandat të mjaftueshëm për të përmbushur misionin e saj, mandat që në tërësi të tij nuk ka kufizime që çenojnë punën tonë. Ky dimension është vlerësuar maksimalisht. Ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka qënë një hap i rëndësishëm për të sanksionuar si aksesin në informacion dhe të drejtën dhe detyrimin për raportim, dimensione që kanë përmirësuar ndjeshëm performancën institucionale. Nisur nga aspekti i të drejtës, dimensionet që përcaktojnë mandatin e KLSH vlerësohen me 4 pikë.

² Per secilin dimension dhe fushë niveli i pikëzimit është në trend rrites nga 0-4 ku niveli 4 është niveli maksimal.

Tregu esi	Pavarësia dhe Korniza Ligjore	Dimensionet	Pikëzimet
SAI-1	Pavarësia e SAI-t	(i). Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive	4
		(ii). Pavarësia/autonomia financiare	3
		(iii). Pavarësia/autonomia organizative	4
		(iv). Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe menaxherëve të tjerë të institucionit	4
SAI-2	Mandati i SAI-t	(i). Mandat i mjaftueshëm	4
		(ii). Akses në informacion	4
		(iii). E drejta dhe detyrimi për raportim	4

Gjykata Austriake e Auditimit konkludoi se aktiviteti i KLSH-së është në përputhje me: Deklaratën e Limës (ISSAI 1), Deklaratën e Meksikës (ISSAI 10) si dhe ISSAI-n 11.

Ky vlerësim për Pavarësinë dhe Kornizën Ligjore të KLSH u prezantua nga Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, në Konferencën e organizuar me rastin e 40- vjetorit të Deklaratës së Limës mbi Pavarësinë e SAI-ve, në Lima, Peru më 5 Dhjetor 2017, duke konfirmuar se.... *pavarësia, mandati dhe organizimi i KLSH janë ligjorisht de facto të vendosura dhe të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Ligji i KLSH-së. Me hyrjen në fuqi të Ligjit në vitin 2015, KLSH pati përmirësime të rëndësishme në pavarësinë e tij, krahasuar me dispozitat e ligjit të mëparshëm. korniza ligjore e vendosur është e përshtatshme dhe efektive dhe qëndron në pajtueshmëri me Deklaratën e Meksikos”.*

Përveç vlerësimit pozitiv, kolegët e Gjykatës Austriake të Auditimit cilësuan si aspekt për përmirësim që ndikon në forcimin e pavarësisë reale, pavarësinë financiare. Pavarësisht faktit që buxheti i KLSH-së dhe numri maksimal i punonjësve janë pjesë e Buxhetit të Shtetit të miratuar nga Kuvendi, fakti që Kryetari nuk ka të drejtë ankimi të drejtpërdrejtë në Kuvend apo në Komisionet Parlamentare për çështje që lidhen me buxhetin e KLSH-së, është aspekt që cënon pavarësinë reale financiare të KLSH.

Liria e plotë në shpërndarjen e buxhetit, si për shembull dhënia e buxhetit si shumë totale dhe dhënia e të drejtës KLSH-së për akordimin e saj në mënyrë autonome, do të nënkuptonte përmbushjen e Deklaratës së Meksikës në një shkallë më të lartë.

Pavarësisht se në vetëvlerësimin tonë, mandati i Kryetarit është i mirëpërcaktuar duke garantuar edhe pavarësinë e tij, sipas kolegëve austriakë, kriteret në nenin që bën fjalë për përfundimin e mandatit të Kryetarit, reflektojnë cënim të pavarësisë së SAI-t.

Sipas kornizës ligjore, KLSH ka mandat të mjaftueshëm dhe akses të plotë në informacion, pasi korniza ligjore është plotësuar sipas standardeve ndërkombëtare të lidhura me të drejtën dhe mandatin për të audituar. Megjithatë gjatë vitit 2017, përsëri kemi ndeshur raste që aktiviteti auditues është penguar dhe refuzuar (respektivisht rasti “Albpetrol” sh.a., i cili u zgjidh me kontributin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe ai i Entit Rregullator të Energjisë, rast ende i pazgjidhur). Ky fakt tregon se mandati de jure i sanksionuar në ligj nuk është arritur plotësisht në praktike.

B. Fusha “Qeverisja e brendshme dhe etika”.

Qeverisja e brendshme si fushë e rëndësishme që ndikon në performancën institucionale të çdo Institucioni Suprem Auditimi, është vlerësuar në përputhje me kërkesat e ISSAI-ve 10,12,20,30, 100. Dimensionet që vlerësohen në Fushën B, pasqyrojnë themelet e SAI-t për kryerjen e aktiviteteve të tij. Sistemi i vetëvlerësimit konkludon se KLSH është drejtuar duke dhënë shembullin e mirë, duke synuar të jetë organizatë model, si dhe ka promovuar transparencën dhe llogaridhënien përmes mirëqeverisjes dhe sjelljes etike.

Në aspektin e Qeverisjes së Brendshme dhe Etikës, vlerësimi bazohet në matjen e Ciklit të Planifikimit Strategjik, ku përfshihen Plani Strategjik, Plani Vjetor, Planifikimi Organizativ dhe Monitorimi, si dhe Raportimi i Performancës Institucionale. Me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe konsolidimin e reformave të ndërmarra, në përputhje me detyrimet kushtetuese, me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI-t, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE-së, si dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të të gjitha palëve të interesit, menaxhimi i ndryshimit dhe zhvillimi institucional është realizuar, duke e konsideruar implementimin e objektivave strategjike si një proces dinamik, duke rivlerësuar, përditësuar, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet e objektivave strategjike. Njëherazi është proceduar me sigurimin e monitorimit të planit strategjik. Raportet e monitorimit kanë shërbyer edhe si një instrument informimi dhe transparence për palët e interesit si publiku, Kuvendi e Komisioni Evropian, dhe të gjitha organizmave ndërkombëtarë, të cilëve u mundësohet vlerësimi i progresit të zhvillimit institucional.

B. Qeverisja e Brendshme dhe Etika			3
SAI-3	Cikli i Planifikimit Strategjik	(i). Përmbajtja e Planit Strategjik. (ii). Përmbajtja e Planit Vjetor/Planit Operacional (iii). Procesi i Planifikimit Organizativ (iv). Monitorimi dhe Raportimi i Performancës	3 3 3 3
SAI-4	Mjedisi i Kontrollit Organizativ	(i). Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative (ii). Sistemi i Kontrollit të Brendshëm (iii). Sistemi i Kontrollit të Cilësisë (iv). Sistemi i Sigurimit të Cilësisë	4 4 3 4
SAI-5	Auditimet me Burimet e Jashtme	(i). Procesi i Përzgjedhjes së Audituesve me Kontratë (ii). Kontrolli i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme (iii). Sigurimi i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme	N/a N/a
SAI-6	Udhëheqja dhe Komunikimi i Brendshëm	(i). Udhëheqja (ii). Komunikimi i Brendshëm	4 4
SAI-7	Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit	(i). Procesi i Përgjithshëm i Planifikimit të Auditimit (ii). Përmbajtja e Planit të Përgjithshëm të Auditimit	3 3

Mjedisi i Kontrollit Organizativ është vlerësuar përmes dimensioneve të lidhura me Mjedisin e Kontrollit të Brendshëm, Etika dhe Integriteti, Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Sistemi i Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemi i Sigurimit të Cilësisë. Të gjitha këto dimensione vlerësohen në përputhje me kërkesat e udhërrëfyesve metodologjikë, modelit COSO, Modelit INTOSAIN, etj.

Nga pikëpamja metodologjike, këta tregues vlerësohen me 4 pikë kundrejt 4, përveç sistemit të kontrollit të cilësisë, ku duhet të përmirësojmë instrumentet metodologjikë për matjen e risqeve që lidhen me cilësinë. Për të arritur këtë, duhet të kemi një sistem për të përcaktuar përparësitë e punës, duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur cilësinë, në zbatim të kërkesave të ISSAI-t 40.

Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm, Etikës dhe Integritetit. Duhet të theksojmë se veprimtaria menaxheriale institucionale këto gjashtë vitet e fundit është fokusuar në sigurimin e sistemit të etikës dhe integritetit institucional, nëpërmjet zbatimit të kornizës rregullative të KLSH-së dhe praktikave më të mira të komunitetit të INTOSAI-t, specifikisht të INTOSAIN (instrumenti i vetëvlerësimit të integritetit). Strategjia për implementimin e një sistemi efektiv të etikës dhe integritetit është fokusuar në tre shtylla kryesore,

1. Hartimi dhe konsolidimi i kuadrit rregullator mbi etikën dhe integritetin. KLSH është radhitur ndër të parat Institucione Supreme të Auditimit, që në mënyrë vullnetare, që prej vitit 2014, ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit (INTOSAIN), konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt në zhvillimin e politikave të integritetit. Parimi kryesor i zbatimit të kësaj metodologjie është “vetëvlerësimi” dhe çelësi i suksesit të aplikimit të këtij instrumenti është roli aktiv dhe kontribues i çdo individi, pjesë e stafit të institucionit.

KLSH ishte një ndër kontribuesit e hartimit të draftit të ri të ISSAI 30 “Kodi i Etikës”, i cili u miratua në Kongresin e XXII-të të INTOSAI-t, në Dhjetor 2016.

Në Korrik të vitit 2017, KLSH u bë anëtare e Grupit të Projektit të EUROSAT “Mbi rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në përhapjen e kulturës etike në sektorin publik”, i cili udhëhiqet nga SAI i Hungarisë. KLSH, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në këtë Grup Pune, synon ushtrimin e auditimit të etikës dhe integritetit në subjektet e auditimit të sektorit publik.

2. Menaxhimi i etikës dhe integritetit, duke vijuar me imponimin dhe implementimin e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve. Në këtë aspekt janë kryer trajnime intensive që kanë synuar edukimin e punonjësve me frymën e standardeve etike dhe vlerave morale.
3. Ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse dhe kontrolluese, investiguese dhe ndëshkuese ndaj sjelljeve dhe shkeljeve të etikës dhe integritetit. KLSH, si rezultat i aplikimit të këtij instrumenti ka marrë masa ndaj punonjësve të tij, të cilët kanë rezultuar me shkelje të rregullave të etikës dhe integritetit. Për periudhën 2012-2017, Komisioni i Etikës i institucionit ka vendosur për 10 largime nga detyra për shkelje të etikës dhe integritetit.

Me shkresën nr. 1182 datë 18.11.2016 te Kryetarit të KLSH-së, i kemi kërkuar Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive e Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), kryerjen e verifikimit të plotë dhe të thelluar mbi deklaratimet e të gjithë punonjësve/drejtuesve të KLSH-së, që mbartin detyrimin ligjor për deklaratim të interesave private (niveli Drejtor dhe Kryeauditues). Nga ILDKPKI u kryen verifikimet bazuar në kërkesat e ligjit përkatës për 28 punonjës dhe në përfundim të këtij procesi nuk rezultuan shkelje të kuadrit rregullator.

Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, është vlerësuar mbi bazë të modelit COSO. KLSH përgjatë vitit 2017 ka vijuar me veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm .

Në zbatim të ISSAI-t 20, KLSH vepron mbi themelet e transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, në zbatim të ISSAI 12 që thekson parimin e udhëheqjes nëpërmjet shembullit, Kryetari dhe menaxhimi i lartë janë përgjegjës për dhënien e shembullit të mirë, për të promovuar integritetin, por gjithashtu për të mundur përmbushjen efektive të mandatit të organizatës duke zhvilluar një kulturë organizative e cila promovon efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri. Në këtë kontekst, në vitin 2018 u rishikua Kodi i Etikës, duke cilësuar se Kryetari pranon pa asnjë kushtëzim Kodin e Etikës së Deputetit të Kuvendit.

Komunikimi i brendshëm është një nga aspektet kryesore për ta mbajtur stafin e KLSH-së të informuar, të motivuar dhe në të njëjtin drejtim me objektivat e institucionit. Ai është një mjet i fuqishëm për të stimuluar rritjen e angazhimit të stafit. Përveç kësaj, trupa audituese luan një rol të rëndësishëm në komunikimin me qytetarët duke nxjerrë në pah rëndësisë e KLSH-së për miradministrimin e parasë dhe të pasurisë publike. Prandaj, i gjithë personeli është i informuar për punën dhe prioritetet strategjike të KLSH-së. Komunikimi i brendshëm është konsideruar një mjet i rëndësishëm për shkëmbimin e njohurive, duke mundur punonjësit të njohin iniciativat e ndërmarra në të gjithë institucionin, rritjen e inovacionit dhe gjenerimin e ideve të reja.

KLSH ka ndërtuar sistemin për të përcaktuar përparësitë e punës në ruajtjen e cilësisë, duke zbatuar metodologjinë bazuar në risk për përcaktimin e auditimeve që do të kryejë. Megjithatë, kriteri i vlerësimit sistematik të riskut përgjatë gjithë fazave të planifikimit, është aspekti që duhet përmirësuar më tej. Për këtë arsye ky dimension është vlerësuar me 3, kundrejt 4 pikëve.

Në lidhje me përmbushjen e kriterëve të vlerësimit të dimensionit “Përmbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit”, u konstatua se KLSH duhet të përmirësojë sistemin e vlerësimit të pengesave dhe të riskut për përcaktimin e prioritetëve të auditimeve, buxhetin dhe burimet njerëzore në dispozicion.

C. Fusha “Cilësia e auditimit dhe raportimi”

Përmes këtij dimensionit “Cilësia e auditimit dhe raportimi”, synohet vlerësimi i cilësisë së punës audituese, si dhe rezultatet e auditimit, aspekt që përbën aktivitetin kryesor të KLSH-së për të tre llojet e auditimit përkatësisht auditimet financiare, të performancës dhe të

përputhshmërisë (duke qënë një periudhë tranzitore aktiviteti auditues përfshin edhe auditimet e rregullshmërisë sipas modelit të vjetër të auditimit).

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën Janar - Dhjetor 2017, ka kryer 156 auditime nga 154 auditime të planifikuara, nga të cilat:

- 92 auditime rregullshmërie;
- 25 auditime përputhshmërie;
- 14 auditime financiare;
- 15 auditime performance;
- 5 auditime tematike;
- 5 auditime të T.I.

Institucioni ka arritur të mbajë një sasi-prag auditimesh, për të siguruar mbulueshmërinë e duhur me auditim në fushat kryesore të shpenzimeve publike dhe të gjenerimit të të ardhurave, prag nën të cilin nuk ka rënë asnjëherë në këto 6 vitet e fundit. Ky nivel i lartë për kapacitetet audituese në dispozicion gjithsesi është shoqëruar edhe me rritje të cilësisë së auditimit dhe një metodologji bashkëkohore, bazuar në Standardet e INTOSAI-t.


Auditimet janë realizuar në institucione qendrore dhe njësi të varësisë, njësi të vetëqeverisjes vendore etj, për të patur një mbulim të kënaqshëm për dhënien e opinionit të Zbatimit të Buxhetit të Shtetit. Janë audituar ministritë dhe agjensitë në varësi të tyre, drejtoritë e përgjithshme dhe degët e tatimeve dhe doganave, si shoqëritë aksionere me kapital shtetëror, si kontribuese të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përmes dividendit dhe jo vetëm, si dhe njësi të vetëqeverisjes vendore, pa anashkaluar auditimin e projekteve me financim të huaj, duke qënë se investimet publike në Shqipëri në masë të konsiderueshme financohen nga këto lloj projektsh. Megjithatë, jemi të ndërgjegjësuar se treguesi i mbulimit mbetet akoma një tregues sfidues, po t'i referohemi metodologjisë së llogaritjes së tij, sipas llojit të auditimeve të realizuara.

Nga auditimet e kryera në vitin 2017, KLSH ka identifikuar mungesë përgjegjshmërie nga titullarët e institucioneve të çdo niveli, mosnjohje të kërkesave të ligjit të menaxhimit financiar, nivele të ulta dhe ineficiencë të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke krijuar risqe për shpenzime jo në përputhje me kërkesat ligjore dhe efektivitet të ulët në harxhimin e fondeve buxhetore. Vijnë praktikat dhe vendimarrjet institucionale me efekte negative në fondet publike, ku niveli i dëmeve dhe shpenzimeve joefektive të konstatuara është:

- Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, *me dëm ekonomik në shumën totale prej 11.5 miliard lekë ose 85.8 milionë euro.*
- Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e fondeve publike të shpenzuara nga subjektet e audituara, në shumën totale prej *99.05 miliard lekë ose afërsisht 739.7 milionë euro nga e cila: 92.7 miliard lekë në fushën e të ardhurave ose afërsisht 692.1 milionë euro dhe 6.3 miliard lekë ose afërsisht 47.8 milionë euro, në fushën e shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve. Në total janë konstatuar shkelje në shumën 110.5 miliard lekë ose afërsisht 825,6 milionë euro.*

Dëmi i konstatuar është në një trend rritës në vitet e fundit dhe kjo duket qartë në paraqitjen grafike të mëposhtme.

Tabela. Dëmi në harkun kohor 2002-2017 në miliardë lekë



Burimi. KLSH Sektori i Statistikave

Treguesi i dobishmërisë së auditimit është raporti i sasisë së fondeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH me shpenzimeve buxhetore faktike të KLSH-së dhe është një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit.


Për vitin 2017 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për KLSH-në janë zbuluar dhe kërkuar për t'u zhdëmtuar 31.9 lekë. Në përlogaritjen e këtij treguesi, në shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së për vitin 2017, nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet kapitale për godinën e



Burimi. KLSH Sektori i Statistikave

re të KLSH-së (shpenzimet faktike për vitin 2017 janë dyfishuar në raport me shpenzimet faktike të viteve paraardhëse për shkak të këtij investimi madhor). Nëse do të merret në konsideratë edhe investimi për godinën, treguesi i dobishmërisë është 19.9 lekë.

Për 6 vitet 2012-2017 rezulton se për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së është kërkuar për t'u zhdëmtuar 108.7 lekë, ose 5 herë më shumë, nga 21.1 lekë që është kërkuar në periudhën 10 vjeçare 2002-2011.





Burimi. KLSH Sektori i statistikave


Edhe përgjatë vitit 2017, KLSH ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara, struktura e të cilave ka ruajtur të njëjtën tipologji sikurse vitet e tjera. Masa për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore për periudhën Janar-Dhjetor 2017 janë **3521 masa**, nga të cilat janë pranuar 1937 ose 55% e masave të rekomanduara dhe 1584 masa janë duke u shqyrtuar nga subjektet.

A- 91 “Masa për përmirësime ligjore”, nga të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi 29 masa ose 31% dhe 62 masa janë duke u shqyrtuar nga subjektet.


B- 2082 “Masa organizative”, nga të cilat janë pranuar dhe janë në proces zbatimi 1108 masa ose 51% dhe janë në proces shqyrtimi 974 masa.



C- 341 “Masa administrative”, nga të cilat janë pranuar 222 masa ose 65% dhe janë zbatuar 151 masa ose 44% dhe janë në proces shqyrtimi 119 masa.



D- 1007 “Masa Disiplinore”, nga të cilat janë pranuar 578 masa ose 57%, janë zbatuar 202 ose 34% dhe janë në proces shqyrtimi 429 masa.



Puna audituese është përqëndruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vlerësuar një nivel të lartë rishikimi dhe ku sistemet e kontrollit janë të niveleve që nuk mund të garantojnë dhe japin siguri për një aktivitet në përputhje me kërkesat e kuadrit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Edhe në këtë vit, *shkeljet më të mëdha me efekte të qënësishme në shpenzimin e fondeve në kundërshtim me kërkesat ligjore, mbeten në fushën e keqmenaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të fondeve buxhetore, keqadministrimit të pronës shtetërore, pasuar nga parregullsitë dhe ineficiencat e fushës së prokurimit publik.*

Duke synuar rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga institucionet publike, KLSH ka nxitur bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe institucionet e tjera qëndrore dhe të pavarura, për të zbatuar një sistem të përbashkët për rekomandimet e dhëna, si nga auditimi i jashtëm ashtu edhe ai i brendshëm, duke synuar rritjen e nivelit të kontrollit në përgjegjshmërinë e zbatimit të rekomandimeve, si një instrument për të luftuar keqpërdorimin e parasë dhe pasurisë publike.

Standardet e Auditimit dhe Menaxhimit të Cilësisë

Auditimi financiar përbën një nga aktivitetet audituese më tradicionale, por për shkak të niveleve të deformuara të raportimit financiar në sektorin publik (pas viteve 90-të), për praktikën e KLSH mbetet një lloj i ri auditimi. Për vitin 2017, nga KLSH është dhënë opinion për pasqyrat financiare të 14 njësive publike.

Numri mbetet akoma i vogël, por në kushtet e realitetit shqiptar, kur kemi mungesë të një kornize të plotë të raportimit financiar në sektorin publik, mungesë të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të Shtetit, mungesë të pasqyrave të konsoliduara në nivel qëndror, ku raportimi financiar nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri realizohet mbi bazën e mjeteve monetare, por me elementë të administrimit të aktiveve, të angazhimeve,

debitorëve dhe kreditorëve, niveli i mbulimit nuk është tregues që mund të reflektojë kriteret e kërkuara sipas standardeve të auditimit.

Gjatë këtyre viteve, opinioni i KLSH mbi raportimin financiar në sektorin publik ka qenë i fokusuar vetëm në aspekte të caktuara dhe është shoqëruar me kërkesa të përsëritura, për nevojën që raportimi financiar në sektorin publik të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS). Kjo situatë ka sjellë që KLSH, në harmoni me zhvillimet e raportimit financiar në sektorin publik të drejtuar nga qeveria, të punojë me qëllim garantimin e kapaciteve institucionale të përshtatshme, për të kryer auditime financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarë të auditimit (SNA) mbi pasqyrat financiare të sektorit publik të përgatitura në përputhje me IPSAS. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2017, KLSH ka vijuar me kryerjen e auditimeve financiare në disa njësi publike, duke u ndihmuar në këtë fushë edhe nga ekspertiza e SAI-t Polak (NIK), i cili ka angazhuar ekspertë të tij, në mbështetjen e dy auditimeve financiare pilot të KLSH.

Korniza e Matjes së Performancës kërkon adoptimin e Manualit të Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, në përputhje me ISSAI 200 dhe ISSAI 400. Në lidhje me këtë dimension, KLSH është vlerësuar se i përmbush pjesërisht (2-3 pikë nga 4) kërkesat e përcaktuara sipas praktikave më të mira ndërkombëtare.

- Për auditimet financiare, KLSH përmbush plotësisht 20 nga 21 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi. Është vlerësuar si e përmbushur pjesërisht, kërkesa për përcaktimin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi, nivelin e materialitetit ose nivelet që do të zbatohen për lloje të veçanta të transaksioneve, gjendjet e llogarive apo dhënien e informacioneve shpjeguese.
- Për auditimet e përputhshmërisë, KLSH i përmbush plotësisht plotësisht 11 nga 18 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi. Janë vlerësuar si të përmbushura pjesërisht, kërkesat në lidhje me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të auditimit, të kuptuarit të mjedisit të kontrollit dhe kontrollit e brendshme përkatëse, si dhe ndërtimi i procedurave të përshtatshme të auditimit, që adresojnë nivelin e risqeve të identifikuar. KLSH ka vlerësuar si të pamjaftueshme procedurat e kryera gjatë auditimeve të përputhshmërisë, në lidhje me identifikimin e risqeve të mashtrimit financiar, si dhe hartimit të strategjisë dhe planit të auditimit.
- Për auditimet e performancës, KLSH përmbush plotësisht plotësisht 6 nga 21 kërkesat e këtij dimensionit vlerësimi. Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesave, konstatohet se përmbushen në nivel pjesor.

Menaxhimi i Grupit të Auditimit dhe Aftësitë e Vlerësimit

Ky dimension kërkon krijimin nga SAI të një sistemi, për të siguruar që grupi i auditimit si një i tërë, ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për realizimin e misionit auditues:

- Për auditimet financiare, KLSH ka plotësuar plotësisht 10 nga 11 kërkesat e përcaktuara në modulën e vlerësimit për auditimet financiare. Është vlerësuar si e përmbushur

pjesërisht kërkesa për ekspertizën teknike, duke përfshirë ekspertizën e T.I. dhe fushat e specializuara të kontabilitetit ose auditimit. Përdorimi gjithnjë e më i gjerë i sistemeve IT në fushën e raportimit financiar në sektorin publik, kërkon që KLSH të zhvillojë në mënyrë të vazhdueshme kapacitetet në auditimin e këtyre sistemeve, në funksion të efektivitetit të auditimeve financiare.

- Për auditimet e përputshmërisë, niveli i kriterëve mbetet njësoj me auditimet financiare, ku KLSH rezulton se i përmbush pjesën më të madhe të kriterëve dhe pjesërisht disa prej tyre. Veçanërisht, vlerësohen si pjesërisht të përmbushura kërkesat për identifikimin e njohurive, aftësive dhe ekspertizës së kërkuar për realizimin e punës audituese, duke përfshirë edhe vlerësimin për përdorimin e punës së ekspertëve të jashtëm.

Kontrolli i Cilësisë

Po t' i refererohemi kërkesave të lidhura me *Kontrollin e Cilësisë* në auditimin financiar dhe të përputshmërisë, KLSH përmbush plotësisht kriteret e vlerësimit. ISSAI 40 kërkon që e gjithë puna e kryer duhet të jetë subjekt i rishqyrtimit, si një mjet për të kontribuar në cilësinë dhe nxitjen e të mësuarit dhe zhvillimit të personelit. Në këtë proces, përfshihet rishikimi i planit të auditimit, letrave të punës dhe punës së grupit, si dhe monitorimi i rregullt i ecurisë së auditimit nga nivelet e përshtatshme të menaxhimit. Shqyrtimi ndihmon KLSH-në për të siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullore të zbatueshme, si dhe se raporti i audituesit me mjedisin është i përshtatshëm.

Në funksion të sigurimit mbi cilësinë e dosjeve, për auditimet e evaduara gjatë vitit 2017, me Urdhrin nr. 12 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, datë 30.01.2018 “Për Kontrollin e Sigurimit të Cilësisë”, të ndryshuar, është realizuar vlerësimi i sigurimit të cilësisë për 46 dosje, të cilat përbëjnë 30% të dosjeve të evaduara gjatë vitit 2017. Përzgjedhja u bë në mënyrë të rastësishme, duke prekur si auditimet financiare edhe ato të performancës, nga subjekte të institucioneve qendrore deri tek njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë aksionere.

Procesi i vlerësimit ka përfshirë gjithë ciklin e procesit auditues:

1. Planifikimi i auditimit/hartimi i programeve të auditimit
2. Kryerja e auditimit dhe
3. Raportimi dhe evadimi i materialeve të auditimit.

Vlerësimi është bërë bazuar në 21 tregues, për secilën dosje me një pikëzim të përshkallëzuar nga 1 (shumë mirë) në 4 (jo mjaftueshëm), referuar faktit nëse auditimi ka përmbushur kërkesat optimale të ligjit, të rregullores së brendshme dhe standardeve të auditimit, për secilin nga kriteret e vlerësimit.

Në përfundim të veprimtarisë së kontrollit të zbatimit të cilësisë, rezulton se puna audituese reflekton përmirësim të dukshëm, referuar kornizës rregullore të procesit auditues, mbi 60 % e dosjeve të auditimit vlerësohen të mira dhe vetëm 13 % janë vlerësuar “mjaftueshëm”.

Procesi i Planifikimit

KLSH plotëson pjesërisht kërkesat e lidhura me procesin e planifikimit, si për auditimin financiar, ashtu dhe atë të përputhshmërisë dhe të performancës. Përveç sfidave në lidhje me përcaktimin e materialitetit, në auditimin financiar dhe në vlerësimin e risqeve në auditimet e përputhshmërisë, KLSH duhet të zhvillojë më tej procesin e hartimit, zbatimit, dhe monitorimit të një strategjie të përgjithshme auditimi, që përfshin qëllimin, kohështirjen dhe drejtimin e auditimit. Në këtë strategji, duhet përcaktuar natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të vlerësimit të riskut, si dhe natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të planifikuara të auditimit, në nivelin e pohimeve të auditimit. Deri tani, puna e KLSH ka vijuar me program auditimi, por si pjesë e auditimeve pilot, me SAI-n Polak po punohet për standardizimin dhe përfshirjen e strategjisë së auditimit, si pjesë e letrave të punës. Për më tepër, KLSH duhet të fokusohet që gjatë auditimeve financiare, të identifikojë gjithashtu dhe risqet e anomalive materiale, si pasojë e mospërputhjes materiale me ligjet dhe rregullat, aspektet e përputhshmërisë, çështje kjo që po trajtohet gjithashtu si pjesë e auditimeve pilot me SAI-n Polak.

Puna audituese

Në lidhje me realizimin e procesit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë si dhe vlerësimit të evidencave të auditimit, KLSH përmbush pjesërisht kërkesat e kriterëve të vlerësimit. Kryerja e auditimit në bazë risku është një prioritet i KLSH dhe për këtë jemi duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për planifikimin, ekzekutimin dhe raportimin, në bazë të kësaj metode auditimi, duke garantuar që opinionin e auditimit të bazohet në evidencat të përshtatshme. KLSH gjithashtu po lëviz gradualisht nga dokumentimi vetëm i gjetjeve të auditimit, në dokumentimin e të gjitha testeve të kryera, ku duhet të përfshihen në të edhe evidencat e mjaftueshme të auditimit, për të mbështetur konkluzionet e nxjera, duke pasur parasysh edhe riskun e vlerësuar të anomalive materiale, si pasojë e mashtrimit financiar, ose mashtrimit të dyshuar gjatë auditimit. Kjo, me qëllim që të sigurohemi që janë ndërmarrë të gjitha procedurat e planifikuara të auditimit, ose kur nuk janë ndërmarrë të gjitha procedurat e planifikuara, të jetë në dosjet e auditimit një shpjegim se pse nuk u kryen, i cili duhet të jetë i aprovuar nga personat përgjegjës për auditimin. Objektivi do të quhet i përmbushur, kur të gjitha dosjet e auditimit të përmbajnë dokumentimin e auditimit, që është i mjaftueshëm për t'i mundësuar një audituesi me përvojë, pa njohuri paraprake të auditimit, të kuptojë natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të kryera të auditimit, rezultatet dhe evidencat e marra të auditimit.

Raportimi i rezultateve

KLSH është vlerësuar se i përmbush plotësisht kërkesat, në lidhje me dorëzimin dhe publikimin në kohë të rezultateve të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë. Në përputhje me praktikën më të mira, SAI-et duhet të krijojnë një praktikë për vlerësimin e materialitetit, me qëllimin përcaktimin se kur një procedure e ndjekjes së rekomandimeve kërkon një auditim shtesë.

Në tërësi, aktiviteti auditues i KLSH-së në zbatim të standardeve të INTOSAI-t si dhe të praktikave më të mira të të gjithë komunitetit të SAI-ve është vlerësuar. “*Kontrolli i Lartë i*

Shtetit ka ndërmarrë reforma të mëdha, të cilat e kanë përafruar me modelet dhe metodologjinë audituese evropiane. Në Shqipëri keni arritur një standard të lartë si institucion shtetëror, ndërsa puna juaj ka shënuar impakte të rëndësishme për mirëqeverisjen në vend. Si President i SAI-t çek dhe si zy. President i EUROSAT-t dëshiroj të konfirmoj vullnetin tim për të mbështetur Kontrollin e Lartë të Shtetit në kapërcimin e sfidave që has në implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit”, është shprehur Presidenti i Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Çekisë, Ing. Miloslav Kala, gjatë vizitës së tij në Tiranë në datat 1-2 gusht 2017)

Gjithashtu, përgjatë realizimit të aktivitetit auditues dhe më gjerë, KLSH ka zbatuar me korrektësi dhe profesionalizëm rekomandimet e adresuara nga BE në Progres-Raportin e fundit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, të cilat konsistojnë në: *“KLSH të rrisë numrin e auditimeve pilot financiarë/ të përputhshmërisë/ rregullshmërisë, në përputhje me manuallet e përditësuara dhe standardet e auditimit të INTOSAI-t”*.

Auditimet e performancës janë parë si një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Sfida më e madhe për këtë lloj auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se **auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në rradhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet**. Zhvillimi i auditimeve ka qenë në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik 2013-2017 të KLSH. Gjatë vitit 2017, janë realizuar 15 auditime performance në reformat qeveritare, në aspekte të rëndësishme të financave publike, në sistemin e prokurimit publik, sistemin arsimor, projektet mjedisore, si dhe në shërbimet publike.

Vlerësimi i dimensionit *“Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës”* në KLSH, ka dëshmuar një *“nivel të qëndrueshëm”* të tij. Grupet audituese në auditimet e performancës, për shkak të vetë natyrës së këtij auditimi, kompozohen të tilla që të mbulojnë fusha të ndryshme profesionale (ekonomike, juridike, sociale, etj.) Synimi në këtë drejtim ka qenë krijimi i një bërthame grupesh të qëndrueshme auditimi, me kolegë të cilët plotësojnë njohuritë dhe eksperiencat e njëri-tjetrit.

D. Fusha “Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse”.

Vlerësimi i kësaj fushe tregoi se KLSH ka një menaxhim organizativ të përshtatshëm dhe struktura mbështetëse që sigurojnë një qeverisje të mirë, dhe që mbështetin kontrollin e brendshëm dhe praktikën e menaxhimit (në përputhje me kërkesat e ISSAI-t 12, Parimi 9). Kjo gjetje është gjithëpërfshirëse si për menxhimin e aseteve dhe të shërbimeve mbështetëse të institucionit. KLSH, në zbatim të ISSAI-t 20, ka menaxhuar transaksionet e tij me ekonomicitet, efikasitet, dhe efektivitet dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Sistemi i vlerësimit të performancës në lidhje me dimensionin e planifikimit dhe përdorimit të aseteve dhe infrastrukturës, tregoi se duhet përmirësuar planifikimi afatgjatë për nevojat e infrastrukturës, në përputhje të objektivave strategjike të zhvillimit institucional.

D. Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse			4
SAI-21	Menaxhimi	<i>(i). Menaxhimi Financiar</i>	4
	Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse	<i>(ii). Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës</i>	3 4
		<i>(iii) Shërbimet Administrative Mbështetëse</i>	

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese të KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP), të hartuar gjatë procesit të PBA(Planifikimit Buxhetor Afatmesëm) 2017-2019. Ai është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në dokumentin themelor të zhvillimit institucional, që është Strategjia e zhvillimit të KLSH-së 2013-2017, e rishikuar. Politika buxhetore e këtij programi, ka synuar përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve kushtetueses dhe ligjore, të objektivave si dhe prioritetëve të institucionit, të parashikuara në Planin e Zhvillimit Strategjik 2013-2017 të rishikuar, duke marrë në konsideratë kërkesat e përcaktuara në MSA-së Shqipëri-BE dhe të monitoruara nga DG-Budget, në kuadrin e Integritimit European. Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas programit, për vitin 2017, si dhe niveli i realizimit të tyre, paraqiten në mënyrë të detajuar në Raportin Vjetor të Performancës. Përgjatë vitit 2017, në respektim të planit të veprimtarisë audituese, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka kryer auditimin e rregullshmërisë financiare të aktivitetit ekonomiko- financiar të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga 1 janar 2017 deri 31 dhjetor 2017.

Gjatë vitit 2017, u realizua ngritja e infrastrukturës së T.I. në ambientin e godinës së re si dhe investimi në krijimin e një sistemi informacioni, për menaxhimin dhe mbështetjen e proceseve të auditimit në KLSH. Ky investim realizoi një sistem elektronik për administrimin në KLSH, nëpërmjet menaxhimit të aktivitetit, çështjeve, proceseve, raportimeve, në një platformë software[softuer] të integruar dhe me workflow[uërkfflou] të automatizuara, në përputhje me manualet dhe rregulloren në fuqi, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit. Nëpërmjet këtij investimi, është synuar: *Optimizimi i procesit të auditimit, duke respektuar parimet mbi të cilat ai mbështetet; Rritja e efijencës me anë të sigurimit të kontekstit të plotë të rastit për audituesin; Përmirësimi i performancës, produktivitetit dhe efijencës operationale të brendshme; Përmirësimi i monitorimit dhe rritjes së efijencës së administrimit të çështjeve; Përmirësimi dhe garantimi i transparencës dhe monitorimit të aktivitetit të organizatës, në zbatim të objektivave.*

Gjejmë rastin të falënderojmë Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit si dhe Qeverinë, për disponibilitetin dhe vullnetin pozitiv të treguar për akordimin e fondeve dhe mbështetjen e KLSH-së, lidhur me komponentin e infrastrukturës, godinës, ambienteve të punës dhe te teknologjisë së informacionit, por duke sjellë në vëmendje se nevojat për fonde financiare janë të pamjaftueshme, sidomos ato lidhur me koston e punës dhe të kontraktimit të ekspertëve të jashtëm, kosto të cilat do të bënin të mundur plotësimin edhe të kërkesave nga ekzekutivi për mbulim me auditim të të gjitha njësive të qeverisjes vendore, apo auditimin e koncesioneve dhe privatizimeve, si kërkesë e Komisionit të Ekonomisë.

E. Fusha “Burimet Njerëzore dhe Trajnimi”

Ky aspekt i aktivitetit është vlerësuar bazuar në ISSAI-n 40, si dhe në Udhëzuesin e Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI-t mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kuadrin Institucional të Ndërtimit të Kapaciteteve. Kjo fushë tregon performancën e KLSH-së në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Aspektet dimensionale të vlerësuara lidhen me: Funkzioni i Burimeve Njerëzore, Strategjia e Burimeve Njerëzore, Rekrutimi i Burimeve Njerëzore dhe Shpërblimi, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit

E. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi			3
SAI-22	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore -3-	(i). <i>Funksioni i Burimeve Njerëzore</i>	3
		(ii). <i>Strategjia e Burimeve Njerëzore</i>	3
		(iii). <i>Rekrutimi i Burimeve Njerëzore</i>	4
		(iv). <i>Shpërblimi, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit</i>	4

Menaxhimi i burimeve njerëzore në KLSH është konsideruar si parakusht dhe jetik për funksionimin e institucionit në mënyrë efikase dhe të efektshme. KLSH, në kuadrin e reformimit dhe modernizimit institucional ka zbatuar në vijimësi politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila është në një linjë me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe me parimet e praktikave më të mira të administratës publike, të rekomanduara nga Bashkimi Evropian. Në bashkëpunim me ekspertët e NIK-ut polak, në kuadër të projektit IPA 2013, gjatë vitit 2017 u hartua dokumenti i Politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit, dokument i cili u miratua me Vendimin e Kryetarit nr. 228 dt. 31.12.2017. Aspekti i hartimit të një plani konkret masash për zhvillimin profesional të përshtatshëm të personelit, duhet përmirësuar më tej.

Struktura organizative, për vitin 2017 është miratuar me 181 auditues dhe punonjës mbështetës. Nga viti 2011 dhe 2012, vite në të cilat struktura ka pasur një numër total prej 156 auditues dhe punonjës mbështetës, dinamika e shtimit të numrit të tyre ka rezultuar 5 auditues çdo vit, duke kulmuar me 181 auditues dhe punonjës mbështetës për vitin 2017. Kjo rritje reflekton shtimin e kërkesat në volum dhe cilësi, si dhe kompleksitetin e aktiviteve subjekte të auditimit të KLSH-së. Rritja në numër e audituesve ka sjellë reduktim të numrit të ekspertëve të jashtëm të kontraktuar nga KLSH, të cilët përfaqësonin personalitete me kontribute të njohura në fushat dhe disiplinat përkatëse apo dhe ish-auditues me përvojë. Profesionet kryesore të stafit auditues janë Financier dhe Jurist. Për vetë natyrën dhe kompleksitetin në rritje të aktiviteve nën auditim, të cilat kërkojnë interpretim financiar dhe ligjor, kërkesa për këto dy profesionë do të vijojë të mbetet prioritare. Barazia Gjinore dhe ulja e moshës mesatare të punonjësve janë drejtime të politikës së burimeve njerëzore, treguesit e të cilave janë përmirësuar. Për vitin 2017, raporti femra/meshkuj është 40 % me 60%, nga 33 % me 67% që ishte në vitin 2011, duke patur si objektiv që për dy vjet të arrihet në raportin 50% me 50%. Ndërsa moshja mesatare në KLSH në fund të vitit 2017 është 42.9 vjeç, nga 50 vjeç në vitin 2011. Objektivit për dy vitet e ardhëshme është të realizohet barazia gjinore 50% me 50%, si dhe moshja mesatare 40 vjeç.

KLSH ka zbatuar politika efektive të menaxhimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore, bazuar në tre parimet bazë: i) vlerësimi i profesionalizmit, ii) i transparencës dhe iii) konkurimi i hapur dhe mundësia e pjesëmarrjes për të gjithë të interesuarit.

Politikat e rekrutimit të punonjësve janë aplikuar në një linjë me strategjinë e zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të plotësuar kërkesat e tanishme dhe të perspektivës. Si një proces shumë i rëndësishëm për performancën e institucionit, rekrutimi është realizuar sipas të gjitha procedurave, rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civilë. Gjatë vitit 2017, janë rekrutuar 22 punonjës, nga të cilët 1 drejtues me titullin “Profesor Doktor”, 2 drejtues me Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim dhe një auditues me titullin Doktor i Shkencave”.

- 8 Drejtues kanë titullin "Profesor" dhe "Profesor i Asocuar" dhe “Doktor i shkencave”,
- 19 Drejtues dhe auditues kanë një diplomë të dytë, nga të cilët 14 në Drejtësi dhe 5 në Financë, - 5 Drejtues dhe auditues kanë Diplomë/Çertifikatë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe Çertifikatë Ndërkombëtare në Auditim (CPA).

E. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi			3
SAI-23	Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional-3-	<i>(i).Planet dhe Proceset për Zhvillimin dhe Trajnimin Profesional</i>	3
		<i>(ii). Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar</i>	3
		<i>(iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Performancës</i>	3
		<i>(iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Pajtuëshmërisë</i>	3

Sistemi i Zhvillimit Profesional reflekton efektivitetin e politikave të rritjes së kapaciteteve profesionale të KLSH në vite, për të cilat treguesit e performancës përfaqësohen në nivele rreth 14 herë më të larta, krahasuar me vitin 2011, kur ky nivel ishte vetëm 2,1 ditë mesatare trajnimi për auditues, ndërsa në fund të vitit 2017 stafi auditues ka ndjekur mesatarisht 28.5 ditë trajnimi për çdo auditues. Kjo qasje mundëson që stafi të ketë akses në praktikat më të mira të fushës së auditimit në sektorin publik dhe të kontribuojë në zhvillimin institucional të qëndrueshëm, të pavarur dhe shembull i profesionalizmit, integritetit dhe etikës. Është synuar sinergjizimi i punës ndërmjet audituesve, mbi moton “*Të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri*”.

Përmbajtja dhe formati i trajnimeve ka konsideruar nevojën e audituesve për trajnime të një niveli të lartë, që të harmonizojnë më së miri dijet teorike me njohuritë praktike, si dhe qasje efektive interaktive. Për të maksimizuar cilësinë dhe diversitetin e njohurive në procesin e trajnimit, KLSH ka synuar diversifikimin e burimeve të trajnimit, duke gërrshetur kapacitetet e brendshme me ato të huaja të ekspertizës, si dhe qasjen në disa komponentë të tematikës së trajnimit. Si objekt parësor është trajnimi i njëkohshëm, në drejtim të zhvillimit metodologjik dhe të përditësimit të njohurive në fushën e ligjeve dhe kuadrit rregullator të subjekteve që auditohen.

10 Auditues të KLSH-së kanë përfunduar trajnime, nëpërmjet intershipeve me afat 5 mujor nga Gjykata Europiane e Audituesve (ECA) dhe 3 drejtues e auditues, përmes fellowship-eve me afat 4 mujor nga Zyra e Auditimit Qeveritar të SHBA-së, GAO.

Politika e ndërthurjes së auditimeve me strukturimin e trajnimeve është vlerësuar edhe nga Drejtoresha e Qendrës për Ekselencë në Auditim të GAO-s, znj. St.Laurent e cila cilëson se: “Vlerësoj fleksibilitetin e KLSH-së në përcaktimin e numrit dhe llojeve të auditimeve që do të realizohen, e cila është esenciale për veprimtarinë e një Institucioni Suprem Auditimi. Një indikator i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve audituese është programi i trajnimeve. Në këtë fushë, KLSH ka krijuar një traditë solide, për të cilën GAO jep kontributin e saj përmes fellowship-eve për audituesit shqiptarë” (nga fjala gjatë vizitës së saj në KLSH, më 23-24 mars 2017).

Megjithatë, sistemi i matjes së performancës në këtë dimension identifikoi aspekte që duhen të përmirësohen më tej, si strategjia e të mësuarit dhe plani vjetor për zhvillimin profesional dhe trajnimin të jenë në përputhje me strategjinë e burimeve njerëzore, të lidhur me qëllimet/objektivat e përcaktuara në planet strategjike dhe operacionale të KLSH-së, si dhe të jenë të bazuar në rezultatet e analizës së nevojave për të mësuar.

F. Fusha “Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit”

Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të tjera

Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit, është vlerësuar në përputhje me kërkesat e ISSAI-t 12. KLSH ka përdorur të gjitha instrumentet e rekomanduara nga praktikantët më të mira, me qëllim që të rriten njohuritë e palëve të interesit dhe që ata të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë e audituesit të pavarur të sektorit publik. KLSH, jo vetëm ka identifikuar palët e interesit, por ka zhvilluar strategji komunikimi me ta, duke përsosur kanalet e komunikimit dhe menaxhimit për të përfshirë të gjithë këto palë interesi. Duke marrë mësim nga homologët tanë, komunikimi është konsideruar një instrument i rëndësishëm për të rritur besimin e qytetarëve pasi siç ka thënë Dr. Josef Moser, ish-President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t për vitet 2004-2016 “... ne do të njihemi për punën tonë vetëm nëse arrijmë të komunikojmë tek qytetarët në mënyrë të qartë atë se çfarë ne bëjmë dhe po ashtu, vlerën e shtuar të gjeneruar nga auditimet tona për Shtetin dhe shoqërinë, në mënyrë që të përceptohemi si institucione strategjike të domosdoshme për interesat e qytetarëve”³

F. Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara			3
SAI-24	Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin- 3-	(i).Strategjia e Komunikimeve	3
		(ii). Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Legjislativin	3
		(iii) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Ekzekutivin	2
		(iv) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin	

³ Fragment nga fjala e Dr. Josef Moser, në Simpoziumin e XXI-të OKB-INTOSAI. Dr. Moser, ish-President i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe ish-Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t për vitet 2004-2016.

		<i>me Gjyqësorin, Prokurorinë dhe Agjencitë Investigative</i>	
SAI-25	Komunikimi me Median, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile -3-	(i). <i>Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Median/Shtypin</i> (ii). <i>Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile</i>	3 4

Strategjia e Komunikimit

Politika e komunikimit është jetike për rolin dhe përmbushjen e misionit të KLSH-së, po ashtu dhe dobishmëria e saj në funksion të maksimizimit të vlerës së raporteve të auditimit, si dhe zbatimit të rekomandimeve. Më 31 korrik të vitit 2017, me Vendim të Kryetarit të KLSH, institucioni ka hartuar dhe miratuar “Strategjinë e Komunikimit të KLSH-së për periudhën 2017-2019”, duke plotësuar në këtë mënyrë edhe objektin që ka pasur si institucion, në kuadër të Planit Kombëtar të Integritetit Europian. Strategjia e Komunikimit është vlerësuar me 3 nga 4 pikë të mundshme.

Strategjia e zhvillimit 2018-2022 përfshin, si pjesë integrale dhe shumë të rëndësishme, suksesin e arritjes së objektivave të vendosura në Strategjinë e Komunikimit 2017-2019. Implementimi në të gjitha dimensionet e Strategjisë së Komunikimit 2017-2019, do të përbëjë instrumentin më efikas për rritjen dhe thellimin e impaktit të aktivitetit auditues, duke synuar edhe forcimin e partneritetit me palët e interesit, duke i bërë ata aleatë besnikë, për të rritur presionin ndaj ekzekutivit për zbatimin sa më të plotë të rekomandimeve të SAI-t.

Moto e INTOSAI-t "Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë" (Experientia mutua omnibus prodest), përbën thelbin mbi të cilin KLSH ka ndërtuar dhe implementuar Strategjinë për Zhvillim gjatë viteve 2012-2017, por dhe filozofinë e këtij dokumenti strategjik për periudhën 2018-2022. Përdorimi i instrumenteve të përshtatshme në realizimin e një mjedisi bashkëpunues me të gjitha palët dhe ruajtja e pavarësisë së auditimit, janë parakushtet për krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit korrekte dhe profesionale.

Në tërësinë e vet, ky vlerësim na inkurajon për t’u ballafaquar me problematikat, si dhe përcakton aspektet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. KLSH do të vijojë angazhimin për të kontribuar në zhvillimet e profesionit të audituesit suprem, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitete bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar dhe rajonal dhe në mënyrë të veçantë në pjesëmarrjen e tij në grupet e punës dhe “task forcave” të krijuara nga EUROSAI dhe INTOSAI për çështje specifike.

Komunikimi me Parlamentin

Praktika e mirë në komunikimin me Parlamentin, është vlerësuar me 3 pikë nga 4 të mundshme. Aspekti që ka nevojë për përmirësim është në përputhje me rekomandimet e dala nga dokumente vlerësuese të SIGMA-s dhe Bankës Botërore/PEFA-s, ku kërkohet që KLSH të theksojë edhe më tej kërkesën për organizimin e dëgjësive publike, në mënyrë të veçantë atyre të Komisioneve Parlamentare me njësitë e audituara. Kjo, me qëllim ndjekjen e zbatimit

të rekomandimeve dhe rritjen e impaktit të raporteve të KLSH. Ndërgjegjësimi i anëtarëve të Kuvendit për përfitimet që i sjell Shtetit dhe shoqërisë një auditim efektiv publik dhe rolin e ndërsjelltë të legjislativit në rritjen e impaktit për shtimin e vlerës së auditimeve të KLSH-së, duhet të qëndrojë në themel të përpjekjeve për të siguruar një ambient të jashtëm mbështetës dhe të dobishëm.

Vullneti për thellimin e bashkëpunimit ka qenë reciprok, pasi edhe Kuvendi ka treguar një vëmendje të veçantë ndaj Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kontributi i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Kryetarit të saj, Sekretarit dhe Kryetarit të Kuvendit ka qenë thelbësor në shtimin e komunikimit. Nga një praktikë e trashëguar raportimi vetëm me dy herë në Kuvend, raport buxheti dhe raportim performance, është intensifikuar komunikimi përmes dërgimit të raporteve të ndryshme të auditimit, apo përmbledhjeve dhe shkresave informuese. Kështu, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka dërguar Kuvendit raporte me ndjeshmëri të lartë publike, ndër të cilat përmendim:

- Informacion mbi rekomandimet e KLSH-së mbi auditimin e Bankës së Shqipërisë;
- Raport mbi Kontrollin e Performancës së Rehabilitimit të ish – Përndjekurve Politike;
- Raport mbi Auditimin e Performancës së Transportit Publik në Bashkinë e Tiranës;
- Raport mbi Auditimin e Performancës, “Ndarja territoriale-administrative në Republikën e Shqipërisë”;
- Raporti i auditimit zhvilluar në Autoritetin Portual, Durrës;
- Raporti i auditimit "Për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë financiare-ekonomike" në OSSHE, OST, KESH;
- Raporti i Auditimit të Performancës "Mbrojtja e konsumatorit nga abuzimet tregtare me peshën dhe matjet" në Autoritetin e Metrologjisë;
- Raporti përfundimtar dhe rekomandimet e KLSH-së për auditimin në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
- Informatat, raportet dhe auditimet e KLSH-së mbi auditimin në "Albpetrol" sh.a;
- Raporti i Auditimit të Performancës në Autoritetin Mbikëqyrës Financiare;
- Informacion mbi integritetin e zyrtarëve të administratës shtetërore,
- Raporti/Vendimi i Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Financave;
- Raporti dhe Vendimi i Auditimit në Drejtorinë e Thesarit;
- Raporti i Auditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Raporti i auditimit "Për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në Komisionin e Prokurimit Publik;
- Raporti i auditimit "Për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë në Agjencinë e Prokurimit Publik;
- Raport mbi Auditimin e Performancës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësor dhe Rural;
- Raport mbi Auditimin e Performancës të Menaxhimit të Borxhit;
- Raport mbi Auditimin e Performancës për Koston e Shërbimeve Spitalore;
- Raport mbi Auditimin e Performancës mbi Cilësinë e ndërtesave para-universitare;
- Raporti/Vendimi mbi Auditimin e Performancës mbi Cilësinë së Ajrit;
- Raporti/Vendimi mbi Auditimin e Performancës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- Raporti/Vendimi mbi Auditimin e Performancës, Unifikimi i pikave doganore me Kosovën, etj.

Komisioni European ka adresuar, gjithashtu, në shtator 2017 rekomandimin “*Shqipëria duhet të përmirësojë implementimin e rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm. KLSH duhet të*

informojë Komisionin e Ekonomisë brenda tremujorit të dytë të vitit 2018 mbi marrjen e masave për monitorimin e pranimet dhe implementimit të rekomandimeve adresuar nga KLSH për vitin 2017". Në zbatim të këtij rekomandimi, KLSH ka hartuar planin e aktivitetit auditues për zbatimin e rekomandimeve për periudhën vijuese të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017.

Praktika e mirë në komunikimin me Ekzekutivin, është vlerësuar me 3 pikë nga 4 të mundshme. Në zbatim të praktikave më të mira të INTOSAI-t, KLSH do të ftojë në mënyrë periodike anëtarët e nivelit të lartë të Ekzekutivit në takime për të diskutuar çështje shqetësuese në lidhje me të dyja institucionet, duke përfshirë gjetjet e përbashkëta, trendet dhe origjinën e shkakut që ka identifikuar, nëpërmjet analizës së raporteve të auditimit

Mbi vlerësimin e dimensionit të *marrëdhënive të KLSH-së me median* vlerësimi është 3 nga 4, duke identifikuar se duhet të organizohen konferenca për shtyp për raportin e tij vjetor dhe duke përfshirë, sipas rastit, raporte të tjera të rëndësishme dhe raporte të auditimit të performancës, në përmbushje të kërkesave të Udhëzimit të INTOSAI-t "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve".

Në fund të vitit 2017, institucioni ka qenë i pranishëm me rreth 100 kronika më shumë se viti 2016, si dhe disa herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar duke gjashtëfishuar praninë e tij në mediat audiovizive, krahasuar me vitin 2010. Ai është prezantuar në median e shkruar me 840 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, kundrejt pothuajse zero gjatë viteve 2010-2011.

Gjatë vitit 2017, KLSH botoi publikoi në faqen e tij në internet www.klsh.org.al 95 përqind të auditimeve që realizoi. Audituesit e institucionit kanë qenë të pranishëm me 125 artikuj, editoriale, shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm.

Institucioni vjen në gjashtë vitet e fundit 2012-2017 me një kolanë botimesh prej 83 titujsh, ndërkohë që në 20 vite (1991-2011), ka vetëm 12 botime, nga të cilat shumica janë broshura informative. Në vitin 2017 u botuan 16 botime me titujt e mëposhtëm:

- "Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm", Vëllimi VII;
- "Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm", Vëllimi VIII;
- "Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm", IX;
- Revista kërkimore shkencore "Auditimi Publik" Nr.15;
- Revista kërkimore shkencore "Auditimi Publik" Nr.16;
- Revista kërkimore shkencore "Auditimi Publik" Nr.17;
- "Raporti vjetor i Performances 2016" (në shqip);
- "Raporti vjetor i Performances 2016" (në anglisht);
- "KLSH Analiza Vjetore 2016";
- "ISSAI 30 – Kodi Etikës - Auditimi i etikës në organizatat e sektorit publik-Si të implementojmë ISSAI 30";
- "Guida e planifikimit të menaxhimit dhe administrimit të aseteve në vetëqeverisjen vendore";
- "Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve"
- "Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939";

- “40 vjet Deklarata e Limës 1977-2017 ”;
- “Auditimet e Performancës në KLSH 2016-2017”;
- “Gjykata Europiane e Auditimit- 40 vjet Auditim Publik”.

Kjo qasje e KLSH-së është vlerësuar edhe nga Drejtoresha e Qendrës për Ekselencë në Auditim e GAO-s amerikane, e cila thekson se: “...i konsideroj inovative botimet e artikujve nga audituesit e KLSH-së në shtypin e shkruar, sepse i shërbejnë forcimit të transparencës duke krijuar linja konkrete komunikimi me qytetarët. Vlerësoj gjithashtu botimet e KLSH-së në vitet e fundit, rekomandimet e dhëna nga institucioni për subjektet e audituara, kallëzimet penale, etj” (nga fjala e znj. St.Laurent, gjatë vizitës së saj në Tiranë, më 23-24 mars 2017).

Dimensioni mbi *Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile*, dëshmon se KLSH e ka konsideruar veten si zëri përfaqësues i interesave të qytetarit dhe i publikut. Statistikat tregojnë se nga një numër i papërfillshëm i letrave (ankesa, kërkesa, informacione, etj) të qytetarëve që institucioni merrte dhe trajtonte në vitin 2011, gjatë viteve 2012-2017, letrat dhe kërkesat nga qytetarët janë rritur jo vetëm në numër, por ajo që është më e rëndësishmja dhe që përbën dallimin cilësor, konsiston në faktin se në çdo rast, qytetarët kanë marrë përgjigje për problemet dhe shqetësimet e ngritura. Vetëm për vitin 2017, KLSH ka trajtuar 623 letra dhe ankesa të qytetarëve, nga të cilat 377 janë konstatuar në kompetencë, ku 204 prej tyre janë verifikuar dhe kanë marrë përgjigje, ndërsa 173 janë në proces verifikimi. Për këtë arsye, vlerësimi i këtij dimensionit rezultoi maksimal, 4 pikë.

Konferenca e V-të shkencore që organizoi KLSH, u zhvillua në datat 11 -13 tetor 2017, në Tiranë dhe u realizua si një bashkëpunim mes Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gjykatës Turke të Llogarive dhe Fondacionit të Kontabilitetit për Bashkëpunim Akademik të Turqisë. Konferenca e këtij viti kishte si temë kryesore “*Të Auditosh për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim*”.

Procesi i zhvillimit dhe modernizimit të institucionit nuk mund të realizohej me eficiencën e duhur, nëse nuk do të mundësohej nga bashkëpunimi i ngushtë me partneret tanë ndërkombëtar, dhe sidomos, pa kontributin e NIK-ut Polak, nëpërmjet projektit të binjakëzimit të financuar nga projekti i BE-së IPA 2013. Projekti i binjakëzimit “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”, i cili nisi të implementohej në KLSH në mars të vitit 2016, ka vijuar të zbatohet në mënyrë të suksesshme edhe gjatë vitit 2017. Projekti është i ndarë në tre komponentë:

Përmirësimi i kornizës ligjore për auditimin;

Zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe kapaciteteve të raportimit, dhe

Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe përmirësimi i impaktit të rezultateve të auditimit.

Gjatë vitit 2017, u kryen 37 misione ekspertësh të huaj, nga të cilat 2 i përkasin komponentit të parë, 24 misione i përkasin komponentit të dytë dhe 11 misione i përkasin komponentit të tretë. Në përfundim të 37 misioneve, ekspertët polakë, kroatë dhe holandezë kanë dhënë mbi 80 rekomandime, mbi bazën e të cilave, me Vendimin e Kryetarit nr. 83, dt. 30.06.2017,

është miratuar Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Projektit IPA për periudhën mars 2016-shkurt 2017. Strukturat e KLSH të ngarkuara me implementimin e rekomandimeve të projektit të binjakëzimit, kanë shqyrtuar këto rekomandime dhe statusin i implementimit të tyre.

Të nderuar deputetë,

Në tërësi, zbatimi i kornizës së matjes së performancës së institucionit, nga pikëpamja metodike, e krahasueshme me atë të partnerëve tanë të komunitetit të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, na inkurajon për t'u ballafaquar me sfidat e së ardhmes, si dhe përcakton aspektet që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm, sipas standardeve të INTOSAI-t dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Puna për rritjen e impaktit të veprimtarisë audituese për një qeverisje më të mirë dhe efëiente të pasurisë publike, kërkon zhvillimin shumë dimensional të institucionit. Vetëm nëpërmjet një partneriteti aktiv me Ju, të zgjedhurit e popullit, me Ekzekutivin, me shoqërinë civile, me partnerët ndërkombëtarë dhe me median, do të arrijmë të jemi rezultativë dhe të suksesshëm, ndaj sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe proceseve të integritetit evropian.

Ju faleminderit!